



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/232

Datë: 18.11.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 48 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 23 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 nëntor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1. nënpika 1.1. e vendimit të Qeverisë Nr.10/226 të datës 23 tetor 2024 për emërimin e Komisionit Ad hoc për Vlerësimin Profesional për Pranim për Pozitën e Kategorisë së Lartë Drejtuese: Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë për Barazi Gjinore, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, si në vijim:
 - 1.1. Në vend të Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë, emërohet, Naim Gashi, Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, kryesues.
2. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit të Qeverisë Nr.10/226 të datës 23 tetor 2024.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/232
Datë: 18.11.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, paragrafit 8. të Ligjit Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 nëntor 2024, merr këtë:

V E N D I M

- Me qëllim të Promovimit të Republikës së Kosovës, i ndahen mjete buxhetore në vlerë prej 11,835€ (njëmbëdhjetë mijë e tetëqindetridhjetepesë euro) Komunës së Kamenicës për organizimin e vizitës në Belfast, më qëllim të promovimit të sistemit të arsimit të përbashkët ndërmjet komuniteteve dhe shkëmbimit të përvojave.
- Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga buxheti i Zyrës së Kryeministrit, nën-programi për Promovim të Vendit dhe barten në xhirollogarinë e Komunës së Kamenicës.
- Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/232

Datë: 18.11.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 30, paragrafit 3. të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, nenit 15, paragrafit 1. dhe nenit 16 paragrafit 3 të Ligjit Nr.08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 nëntor 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrinë së Punëve të Brendshme për transfer dhe rialokim të mjeteve buxhetore deri nën 25% të ndarjes së ndikuar negativisht në total të kategorive të shpenzimeve për vitin 2024.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi merren nga Ministria e Punëve të Brendshme me kod 214, nga kategoritë e shpenzimeve dhe nga nën-programeve si në vijim:
 - Mjetet merren nga kategoritë e shpenzimeve operative, nga nën-programet, si në vijim:
 - Riintegrimi i Personave të Riatdhesuar (kodi 20900) nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere" masën monetare prej 71,500.00€, shprehur në përqindje 24.91 %;
 - Riintegrimi i Personave të Riatdhesuar (kodi 20900) nga kategoria e shpenzimeve "Shpenzime Komunale" masën monetare prej 23,000.00€, shprehur në përqindje 24.73%;
 - Transfer nga Riintegrimi i Personave të Riatdhesuar (kodi 20900) nga kategoria e shpenzimeve "Mallra dhe Shërbime" masën monetare prej 81,000.00€, shprehur në përqindje 24.90%;
 - Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik (kodi 12100) nga kategoria e shpenzimeve "Mallra dhe Shërbime" masën monetare prej 41,758.00€, shprehur në përqindje 24.95% ;
 - Shërbimet e Administratës Qendrore (kodi 11314) nga kategoria e shpenzimeve "Shpenzime Komunale" masën monetare prej 28,000.00€, shprehur në përqindje 24.50%;
 - Departamenti i Standardeve dhe Politikave të IMNQ-së (kodi 12300) nga kategoria e shpenzimeve "Shpenzimeve Komunale" masën monetare prej 388,000.00€, shprehur në përqindje 19.70%;

- Departamenti për Menaxhimin e Reformës në Administratë Publike (kodi 20300) nga kategoria e shpenzimeve “Mallra dhe Shërbime” masën monetare prej 35,006.00€, shprehur në përqindje 24.95%;
- Agjencia e Kosovës për Forenzikë (kodi 35000) nga kategoria e shpenzimeve “Shpenzime Komunale” masën monetare prej 10,300.00€, shprehur në përqindje 24.52%;
- Inspektorati Policor i Kosovës (kodi 32900) nga kategoria e shpenzimeve “Mallra dhe Shërbime” masën monetare prej 186,060.00 euro shprehur në përqindje 24.50%;
- Inspektorati Policor i Kosovës (kodi 32900) nga kategoria e shpenzimeve “shpenzime komunale” masën monetare prej 3,749.00€, shprehur në përqindje 24.50%.

Transferohen në nën programet dhe kategoritë e shpenzimeve, si në vijim:

- Në nën-programin Agjencia e Regjistrimit Civil (kodi 14800) 245,258.00€, në kategorinë e shpenzimeve “Mallra dhe Shërbime”;
- Në nën-programin Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (kodi 12600) shuma prej 388,000€, në kategorinë e shpenzimeve “Mallra dhe Shërbime”;
- Në nën-programin Agjencia e Kosovës për Forenzikë (kodi 35000) shuma prej 45,306.00 € në kategorinë e shpenzimeve “Mallra dhe Shërbime”;
- Shërbimet e Mbështetjes (kodi 30400) Policia e Kosovës në shumë prej 189,809.00€, në kategorinë e shpenzimeve “Mallra dhe Shërbime”.

Rialokim i mjeteve në kuadër të kategorisë së shpenzimeve “Investime Kapitale”, nga nën-programet dhe projektet, si në vijim:

- Nga Departamenti i Standardeve dhe Politikave të IMNQ-së kod i programit (12300) shprehur në përqindje 23.38% nga projektet kapitale si vijon:
- Kompleksi Rilindja-Vlerësimi i Kompleksit Rilindja dhe Renovimi i Aneksëve B, C dhe D me kod (12061), masa monetare prej 510,000.00€;
- Ndërtimi i Shkollës së Muzikës në Prizren, me kod (13478), masa monetare prej 520,860.00€;
- Ndërtimi i Objektivit të Zyrës së KPMM-së, me kod (15235), masa monetare prej 665,780.00€;
- Ndërtimi i Spitalit të Prishtinës, me kod (15732), masa monetare prej 162,700.00€;
- Nga Projekti “Projekti Blinaja, me kod (15057), masa monetare prej 570,000.00€;
- Nga Projekti “Ndërtimi i Ndërtesës për Zyrën e Presidencës” me kod (15715), masa monetare prej 35,000.00€.

Riallokohen në projektet:

- Ndërtimet dhe Renovimet e QRA-ve” me kod (12815), gjithsej masa monetare prej 2,429,340.00€; dhe
- Ndërtimi i Objektivit të KPM, me kod (12806), shuma prej 35,000€.

Transfer i mjeteve buxhetore në kuadër të kategorisë së shpenzimeve "Investime Kapitale", nga nën-programet dhe projektet, si në vijim:

Nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit me kod të programit (12600) transferohen mjete nga këto projekte kapitale:

- Nga Projekti "E-Qeverisja me kod (10423), masa monetare prej 303,936.00€;
- Nga Projekti "Interoperabiliteti " me kod (12658), masa monetare prej 200,000.00€;
- Nga Projekti "Siguria Kibernetike" me kod (18010), masa monetare prej 122,340.00€.

Nga Shërbimet e Administratës Qendrore kodi i programit (11314) nga Projekti "Blerja dhe avancimi i softuerit për MPB-në" me kod (19304), masa monetare prej 124,500.00€, ose shprehur në përqindje 24.90%;

Nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, kodi i programit (35000) nga projekti "Objekti i AKF dhe Dhoma e Dëshmive" me kod (19267), masa monetare prej 113,002.00€, ose shprehur në përqindje 23.37%.

Nga Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave (kodi 32700) nga projektet:

- Ndërtimi dhe Renovimi i objekteve në AME" kodi (13162), masën monetare prej 622,466.00€;
- Furnizim me aparate të fryrjes dhe bombola të ajrit me kod (18012,) masën monetare 62,681.00€;
- Ngritja e sistemit të radio komunikimit me infrastrukturë përcjellëse" me kod (18928), masën monetare prej 37,902.00€;
- Furnizim me automjete për NJPZSh "me kod (14693), masën monetare prej 132,026.00€;
- Furnizimi me pajisje tjera për Shërbime të Zjarrfikësve " me kod (13379), masën monetare prej 606,424.00€;
- Furnizim me pirunar pajisje për bartje të peshave të rënda në AME me kod (19278), masën monetare prej 7,497.00€.

Transferohen në Departamentin e Standardeve dhe Politikave të IMNQ-së kodi i programit (12300) të projekti "Ndërtimet dhe Renovimet e QRA-ve" me kodin (12815), gjithsej masa monetare prej 2,332,774.00€.

Nga Inspektorati Policor i Kosovës (kodi 32900) merren mjetet si vijon:


- Furnizim me pajise për vëzhgim (kodi 15162) masën monetare prej 20,000.00 €; dhe
- Furnizim me Pajisje për Nevoja të Veçanta Operacionale (kodi 19195), masën monetare prej 57,443.00€, shprehur në përqindje 24.50%.

Transferohen në nën-programin Shërbimet e Mbështetjes (kodi 30400) Policia e Kosovës në projektin "Automjete të Blinduara dhe Automjete të Veçanta (kodi i projektit 19195) në kategorinë Investimeve Kapitale.

Nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike (kodi 9015) nga projekti "Ndërtimi i Objektivit të Mensës në AKSP" Kodi i Projektit 18551, shuma prej 204,000.00€ transferohen në nën-programin Shërbimet e Mbështetjes (kodi 30400) në projektin "Projektin Pajisje të TIK-ut, softuere dhe siguria e të dhënave (kodi 19215).

3. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Punëve të Brendshme, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë